



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 19239 prot.

Shkodër, më 26.9. 2025

VENDIM

Nr. 58, datë 25.09.2025

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E NJAC MARKUT, BANESA E TË CILIT ËSHTË
DËMTUAR NGA ZJARRI ”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.09.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; ligjin nr. 68/2017 “Për financat vendore” (i ndryshuar); VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” (i ndryshuar); VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës” (i ndryshuar); VKB nr. 33, datë 29.05.2025 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025, të miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër’” (i ndryshuar); si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së Njac Markut (3 anëtarë familjeje), në vlerën prej 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Njac Markut, në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 160 691 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë dhe për dëmet në orëndi prej 211 416 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Njac Markut.
3. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile, parashikuar në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025, të

miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”(i ndryshuar), në programin AB141, Q2 O1 A4 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme

4. Për familjen e Njac Markut, kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit, hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 41, të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012, pika 3, dhe të VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, pika 3.1/a “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, VKB-së nr. 33, datë 29.05.2025 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025, e miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër’” (i ndryshuar), sipas Relacionit bashkëngjitur, në masën 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 80 346 (tetëdhjetë mijë e treqind e dyzet e gjashtë) lekë dhe në masën 50 % të vlerës së orendive në shumën 105 708 (njëqind e pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 35 vota

Vota Pro	35
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	26.09.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

